



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

PROJEKTVENDIM

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR
TË KUALIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Lidhja nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” e vendimit të Kuvendit nr. 100/2018, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Lidhja nr. 2 “Struktura organizative e personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” e vendimit të Kuvendit nr. 100/2018, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 “Struktura organizative e personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
- III. Anëtar i Komisionit, përfiton pagesën për vështirësi në masën 200% të pagës mujore G3.”
- IV. Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Komisionit për
- V. fiton pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, deri 3 paga në vit.
- VI. Të gjitha pozicionet e punës të stafit administrativ, në njësitë organizative IV, V dhe IV, përfshirë dhe pozicionin e Sekretares së Kryetarit të Komisionit në njësinë organizative I, përfitojnë për natyrë të veçantë pune dhe shkallë vështirësie, pagesë shtesë prej 20,000 lekë në muaj, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare i fillojnë nga data 1 janar i vitit 2020.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____. _____.2019



Lidhja nr. 1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PERSONELTI TË KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri (2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit ***	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR **		(36)
Këshilltarë juristë**	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë Ekonomistë**	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM ***	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN ***		(12)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	2
Përkthyes	II-b	5
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE***		(10)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll/arkivë****	IV-a	1
Magaznier*****	VII	1
Punonjës patrimi *****	III	2
Shofer/Korrier*****	VI	1
Gjithsej		76

Sipas këtij vendimi pozicionet e mësipërme përfitojnë këto shtesa:

**Anëtari i Komisionit, përfiton pagesën për vështirësi në masën 200% të pagës mujore G3, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 29, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*



****Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Komisionit përfiton pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, deri 3 paga në vit, sipas nenit 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".**

*****Të gjitha pozicionet e punës të stafit administrativ, në njësitë organizative IV, V dhe IV, përfshirë dhe pozicionin e Sekretares së Kryetarit të Komisionit në njësinë organizative I, përfitojnë për natyrë të veçantë pune dhe shkallë vështirësie, pagesën shtesë prej 20,000 lekë në muaj, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura (VKM nr. 187/2018)**

****** Specialistët e Protokoll/arkivës përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura (VKM nr. 187/2018)**

******* Përfitimet për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.**

Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

